



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 117, Datë 04.05.2021

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “W.T.S - ENERGJI” SH.P.K., PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 16, SERIA PV04P, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 39, DATË 22.07.2004, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S, MODIFIKUAR ME VENDIMIN E ERE-S NR. 26, DATË 09.04.2009 DHE VENDIMIN NR. 115, DATË 07.10.07.10.2013

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pika 3 dhe nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 19, pika 1, germa “a”, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.05.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 64/2 prot., datë 28.04.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “W.T.S - ENERGJI” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P, miratuar me vendimin nr. 39, datë 22.07.2004, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, modifikuar me vendimin e ERE-s nr. 26, datë 09.04.2009 dhe vendimin nr. 115, datë 07.10.07.10.2013”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “W.T.S - ENERGJI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 617 prot., datë 22.04.2021, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC “Tamarë”.
- Kërkesa për modifikim vjen për arsye se gjatë rikonstruksionit HEC Tamarë, ka pësuar rritje të kapacitetit nga 750 kW, në 1500 kW.
- Me vendimin nr. 39, datë 22.07.2004, shoqëria është pajisur me licencë prodhimi edhe për HEC Tamarë. Më tej me vendimin nr. 115, datë 07.10.2013, “Për modifikimin e licencës së shoqërisë “W.T.S - ENERGJI” sh.p.k, me nr. 16, Seria PV04P, për “prodhimin e energjisë elektrike” nga HEC “Tamarë”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 39, datë 22.07.2004, kapaciteti i instaluar i HEC Tamarë nga 150 kW është rritur në 750 kW.

- HEC Tamarë është privatizuar në vitin 2003 nëpërmjet “Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme” të objektit dhe truallit Hidrocentrali Tamarë, Malësi e Madhe, nr. 2236 Rep., nr. 193 Kol., datë 11.07.2003.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për modifikimin e licencës pranë Raiffeisen Bank në datën 22.04.2021, në vlerën 50 000 lekë në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “W.T.S - Energji” sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton i plotësuar kryesisht si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim;

- Neni 9, pika 1, germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit), **Plotësuar**;
- Neni 15, pika 4:
 - germa “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës, **Plotësuar**.
 - germa “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE, **Plotësuar**.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Nenin 9, pika 1, germa “c” (të dhëna për aplikuesin)

Nenin 15, pika 4,

- germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës; **Pa plotësuar**.
- germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. **Plotësuar pjesërisht**.
Shoqëria duhet të depozitojë:
- Miratimin e pikës së lidhjes për HEC Tamarë me kapacitetin 1500 kW.
- Konfirmimin e Basenit ujëmbledhës Drin-Bunë, për vlefshmërinë ose jo të këtij autorizimi edhe për kapacitetin 1500 kW ose një miratim të ri në vijim të rritjes së kapacitetit të HEC Tamarë, duke qenë se autorizimi i posaçëm për përdorim të burimit ujor është lëshuar në vitin 2010.
- Vlefshmërinë e Lejes së Mjedisit, duke qenë se shkresa e Ministrisë së Mjedisit me nr. 407/3 prot., datë 13.1.2005, “Mbi operimin e disa hidrocentraleve eksiztues”, e cila citon se: “Ndërhyrjet e paraqitura për rehabilitimin e disave prej tyre...konsistojnë në ndërhyrje minimale (ngritje dige deri në 20 cm) dhe për pasojë nuk konsiderohen me ndikime domethënëse në mjedis.”, mban datë shumë të hershme dhe nuk mund të konsiderohet e vlefshme për këtë aplikim
 - germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi; **Pa plotësuar**, do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë ato brenda afateve që përcakton “*Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “W.T.S - ENERGI” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 16, Seria PV04P, miratuar me vendimin nr. 39, datë 22.07.2004, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, modifikuar me vendimin e ERE-s nr. 26, datë 09.04.2009 dhe vendimin nr. 115, datë 07.10.2013, për shkak të rritjes së kapacitetit nga 750 kW në 1500 kW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI